

FATMIRA ISUFI
PËSHPËRITJE BRITMASH
POEZI

BOTIMET TOENA

FATMIRA ISUFI

PËSHPËRITJE
BRITMASH

poezi

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Majlinda Toçi

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928376961

© Autorja

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

Për mamin - e dashura Fiqo

Gozhdim

Nuk e di pse më shfaqesh gjithnjë,
Mefistofel i përjetshëm i vetmisë sime!
S'e di vërtet arsyen...

S'e di vërtet ndodhinë...

Vepra e kryer më ka mbërthyer qenien,
pasoja

përgjithmonë

përthithëse...

Në llumin e zi!

S'e di pse sytë më errësohen,

kur të kujtoj Veprim!

E duart më dridhen nga e heshtura

pështirosje;

Nuk e di pse jam e lidhur kaq fort,

pas kaq vitesh kaluar...

Lodhje

Në dorë një penë e lodhur,
në kokë një mendje - kompleksitet
përcaktohet,
në trup një zemër - brengë,
frikësi,
në trup një shpirt memec.
Sa e lodhshme dita,
sa e frikshme nata,
dhe një qiri me mua
vazhdon të vajtojë.
Drita përvetësuese - brenga e madhe.
Është kaq e vështirë,
lotët përvëlues rrokullisen -
shkëmbinjtë e monotonisë trishtuese,
dëshmia e ekzistencës së humnerës
së pikëllimit,

statuja përmendore e hidhërimit,
statuja loton,
dyshim.

Gjurmë të përjetshme.

Është kaq e vështirë,
e tmerrshme të ndryshosh ndjenjat!

Vetëm

Të endura momentet aviten,
sakaq vazhdoj të jetoj,
me një vetanalizë tren,
me sytë mbijetoj.
Është vërtet qesharak fakti,
arsyeja shoqëruese e pikëllimit.
Është ajër përreth,
është zjarr gjithkund.
Vetmia - një rreth,
ndjenja s'më tund.
Zhytem,
 sipërfaqësohem...
Si një lodër fëmije e harruar
 mbi valë,

askush s'po më dëgjon,
askush s'po më ndien.
Ëndrra të zhuritura,
të përhapura me valën.
Të dallueshme fort sakaq,
porsi gurgullima e një burimi të qetë,
si zhurma e vullkanit të shuar.
A s'është vetmia kjo?
A s'është hyjnia,
bukuria?!

Borxh

Furimi i erërave në zemër,
si gjarpri i uritur në qelq,
zhurmimi i erërave: një emër
si nata e errët që rrjep.

Quhesh gur - dikur,
quhesh gur i zi,
ishte ëndërr dikur
pse është bërë ferr i zi?

Largohem e afrohem.
E fati i nëmur më mundon,
nga realiteti i egër hetohem,
e britma ime më shurdhon.

Horizont i ngushtë, horizont pa ngjyrë.
Kam një merak për ty pasqyrë,
duhet të të këput degën ty pemë,
borxhin e vjetër-kujton, frikacaken amë...

Përkushtim

Dhe ja përsëri,
një kokë e ulur,
me një penë gjysmë të thyer,
hedh shpirt në letër.

Në botën me zhurmë
me në qendër valutën,
të përshkuar nga pikëllimi si turmë
me maratonomak i kundërvihet,

O e mjerë krijimi,
o botë mizore,
iluzioni s'është kurrë i imi,
ëndrrat më shpërbëhen si flokë bore.

Formim

Ëndrrat - që nga shpirti burojnë -
fundërrojnë në palimpsestin e zemrës sonë.
Fjalët - dedikime të reales që shterojnë -
mundohen që ndjenjën e sigurt të tregojnë.
Shembujt - tipizimet që aq shumë masakrojnë -
aviten ngado që tek ëndrra të shpresojmë.
Tingujt - që aq bukur dëgjohen -
mundohen të gjejnë iluzione që fundosen.
Gjestet - janë të vetmet përfaqësuese të botës
shpirtërore -
aq shumë të shpifura saqë objektivizojnë një botë
kafshërore.
Shikimi - provokator mjedisesh,
me sytë mundohet të jetë, e shpirtit, dritare agjentësh.
Ja pra,
ja se çfarë në të vërtetë ne jemi.
Një copë balte,
në duart e fatit!

Ju lutem

Është vërtet vetëm koha ajo,
që më mundon me banalitetin e shprehjes,
ku në emër të përparimit shfarosemi;

që më pengon me shpejtësitë marramendëse,
ku unë duhet të milimetrizoj hapat për mbijetesë;

që më ndalon për shkelje të “ligjeve”,
ku duhet të bëj apologji shpirtërore;

që më cungon - për mungesë idealesh artificiale -
ku patjetër të përshtatem me “përparimin”,
nëse mund të quhet kështu.

Që më edukon me një të thjeshtë pretext
se si të quhem e edukuar në bazat e saj.
Që më transformon për udhëkryqet e ardhshme,
vetëm se shenjat e përvojës mjaftojnë.
Nuk di vërtet nëse kjo natë do të mbledhë
“rrënojat” e saj!

Kur

Kur shikimet akademike mbizotërojnë,
kur të gjithë tingujt njësohen,
kur të gjitha ngjyrat kthehen në baza bardhezi,
kur pasqyra jote nuk të intereson,
kur lotët valë lënë gjurmë faqeve,
është koha e lamtumirës ajo.

Dhe kështu marrim një gënjeshtër -
e stolisim me fjalët pambuk:

për të tharë lotin.

Marrim vargjet,
e bëjmë poezi:

për të shmangur banalitetin e shprehjes.

Marrim melodinë
e mposhtim tingujt e egër:
të kushtëzuar nga realiteti...
Pranimi i lamtumirës
bëhet këngë vaji.
Mbledhim copëzat tona
dhe më së fundi:
“Lamtumirë!”